



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



Nr.04/ 7559 2021

<b>DATA:</b>	30.09.2021
<b>PËR:</b>	Vlora Spanca Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës
<b>PËRMES:</b>	Rufki Suma Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
<b>NGA:</b>	Shabi Rexhallari Drejtor për Buxhet dhe Financa
<b>LËNDA:</b>	Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2020

E nderuar,

Bazuar në nenin 14, paragrafi 5 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit me nr.1163 të datës 21.06.2019, komuna e Hanit të Elezit ka përgatitur Raportin periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2020.

Po ju dërgojmë:

- Raportin periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2020

Me respekt,

## Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit për vitin 2020

Nr	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e basura në zbatimin e rekomandimit
1	<p><b>Çështja A1 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore</b></p>	<p>Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës. Poashtu sipas nenit 31, pika 6, të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar.</p> <p>Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:</p> <p>-Komuna kishte 2,865 prona të regjistruara, mirëpo, sikurse edhe në vitin paraprak, asnjëra prej tyre nuk ishte verifikuar gjatë vitit 2020; dhe</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.</p> <p>Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore si dhe të shtojë kontrollin duke siguruar personel të Tatimit në Pronë që të bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë</p>	<p>Kryetari i komunës ka marrur Vendim për formimin e komisionit për verifikimin dhe regjistrimin e 1/5 apo 20% të objekteve brenda territorit të komunës, nr i protokollit është 02/5408 i datës 29.07.2021.</p> <p>Komisioni ka filluar me e bërë verifikimin apo inspektimin e pronave dhe në bazë të shënimeve që kemi deri me datën 29.09.2021 komisioni ka verifikuar 336 prona apo 11.73% nga numri total i objekteve që është 2,865 prona. Deri në fund të muajit tetor apo më së largu 15 nëntor do të bëhet regjistrimi i 20% të objekteve ku do te</p>	<p><b>Rekomandimi pjesërisht i zbatuar</b></p>	

		<p>-Në vitin 2020 komuna kishte pranuar 95 ankesa (44 objekte dhe 51 parcela) për tatimin në pronë, ku 83 prej tyre ishin aprovuar në favor të tatimpaguesve. Përderisa kishte vonesa në shqyrtimin e ankesave, ku në tri mostrat e testuara kishin vonesë mbi 4 muaj. Mosverifikimi i pronave dhe trajtimi me vonesë i ankesave kishin ndodhë për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19, duke pasur parasysh se një kohë zyrtarët kanë qenë në izolim, pastaj është punuar me reduktime.</p> <p>Poashtu Komuna e Hanit të Elezit nuk kishte zyrtar të kontraktuar për tatim në pronë, vetëm zyrtar me detyrë shtesë.</p> <p>Mosverifikimi i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. Vonesat në trajtimin e ankesave ndikojnë në mos azhurnimin e informatave në kohë për vlerësimin e duhur të tatimi në pronë.</p>	për tatimpaguesit.	përbushet rekomandimi plotësisht.		
2	Çështja A2 - Mos funksionalizimi i sistemit e- Pasuria dhe shpalosje	Rregullorja MF-nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton në mënyrë të qartë që pasuritë nën 1,000€ duhet të regjistrohen në sistemin “e-	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistria dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	Për shkak se ende sistemi E-pasuria nuk është funksional është krijuar databaza në formatin EXCEL për	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar	Mosfunksionalizimi i sistemit E-pasuria që është nën

<p>jo e saktë e pasurive Jokapitale</p>	<p>pasuria". Ne kemi identifikuar mangësi ne menaxhimin e regjistrave të pasurive nën 1,000€ dhe shpалosjen e tyre në PFV si në vijim:</p> <p>Pasuritë e blera nën 1,000€ gjatë vitit 2020 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Shpалosja e pasurive jo kapitale në PFV ishte bërë sipas vlerës së vitit paraprak duke mos i përfshirë edhe blerjet e vitit aktual. Sipas evidencave të thesarit shpenzimet (kodet e pasurive nën 1,000€) për vitin 2020 ishin në shumë 43,254€;</p> <p>Sipas zyrtarëve të komunës sistemi i e-pasurisë ka qenë jo funksional dhe nuk kanë mundur të gjenerojnë raportet e pasurive. Komuna nuk ka mbajtur regjistra të brendshëm për pasuritë jokapitale.</p> <p>Sipas zyrtarëve të komunës sistemi i e-pasurisë ka qenë jo funksional dhe nuk kanë mundur të gjenerojnë raportet e pasurive. Evidenca interne nuk janë mbajtur për të pasur një pasqyrë të saktë të pasurive nën 1,000€.</p> <p>Menaxhimi i dobët i pasurive jokapitale ka ndikuar në shpалosjen jo të saktë të pasurive e që për pasojë kemi një nënvlerësim të pasurive në PFV. Mangësitë e identifikuara, po ashtu ndikojnë që menaxhmenti të mos</p>		<p>regjistrimin e pasurive nën 1000 €.</p> <p>Deri me datën 29.09.2021 nga zyrtari i drejtorisë së administratës kemi marrur raportin që i ka regjistruar pasuri në vlerë prej 33,635.48€ të pasurisë nën 1,000€ të vitit 2020 si vlerë fillestare, ndërsa vlera në libra është në shumë prej 28,085.22€ me zhvlerësim.</p>	<p>menaxhim të MAP-it</p>
---	--	--	---	---------------------------

